



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT "ASTREA"

Nr.900 Prot.

Tiranë, më 19.04.2022

Nr.27-22 Regj.

URDHËR

VENDOSJE SEKUESTRO KONSERVATIVE

Drejtuar : Qendrës Kombëtare të Biznesit ✓

TIRANË

**Për dijëni:** Debitorit – Shoqëria "BUY SELL PROPERTY" SHPK me NIPT L822035040

Adresa: Me shpallje pranë QKB.

**Për dijëni:** Kreditorit – Shoqëria "REAL ESTATE PARTNERS" SHPK.

Adresa: Rruga "Sami Frasheri" përballë Piceri Juvenilja, Kati 5, Tiranë

Unë, Arditi Hajdini Përmbarues Gjyqësor pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "ASTREA" shpk Nipt: L61306025U, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr.Vendimi (11-2021-8710) 1897, datë 13.12.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.27-22, datë 09.03.2022 kërkesën e kreditorit Shoqëria "REAL ESTATE PARTNERS" SHPK, ndaj debitorit Shoqëria "BUY SELL PROPERTY" SHPK me NIPT L822035040, në lidhje me Titullin Ekzekutiv Faturë me Nr.Serial 98051027 datë 02.04.2021 Nr.Rendor 105; Faturë me Nr.Serial 98051028 datë 02.04.2021 me Nr.Rendor 106; Faturë me Nr.Serial 98051048 datë 06.05.2021 Nr.Rendor 125; Faturë me Nr.Serial 98051077 datë 05.05.2021 me Nr.Rendor 154; Faturë me Nr.Serial 98051078 datë 05.05.2021 Nr.Rendor 155; Faturë me Nr.Serial 99862013 datë 03.06.2021 Nr.Rendor 190; Faturë Nr.Serial 99862050 datë 30.06.2021 Nr.Rendor 226; Faturë Nr.Serial 99862055 datë 30.06.2021 Nr.Rendor 231.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit Lajmërimin Nr.572 Prot, datë 09.03.2022, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhëri i Ekzekutimit Nr.Vendimi (11-2021-8710) 1897, datë 13.12.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr. Civile,

Adresa: Rruga "Muhedin Llagami", Kompleksi Square 21, Kulla Nr.4, Kati 11, Ap.3 Tiranë Cel +355 676950155

e-mail : sherbimipermbarimorastrea@gmail.com

**KONSTATOVA Se :**

Me shkresën Nr.572 Prot, datë 09.03.2022, është bërë "Lajmërimi për ekzekutim vullnetar të detyrimit" dhe pasi pala debitore nuk ka marrë dijeni në katër adresa që kishim në dispozicion, është vijuar me Shkresën Nr.700 Prot, datë 28.03.2022 drejtuar QKB e cila ka bërë Shpalljen e "Lajmërimin për Ekzekutim Vullnetar të Detyrimit" Nr.572 Prot, datë 09.03.2022.

Në këto kushte, në zbatim të nenit 36 të ligjit Nr.26/2019 miratuar në datë 08.05.2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat",

**URDHËROJ:**

1. Qendra Kombëtare e Biznesit të vendosë sekuestro konservative mbi aktivet e shoqërisë:
  - **Shoqëria "BUY SELL PROPERTY" SHPK me NIPT L822035040, duke ndaluar tjetërsimin, kalimin dhe çdo veprim tjetër të administratorit, deri në një urdhër të dytë të Përmbaruesit Gjyqësor.**
2. Qendra Kombëtare e Biznesit të na dërgojë një ekstrakt të kësaj shoqërie.
3. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht *brenda afatit ligjor*.
4. Personat që bëhen pengesë, *do të përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe nenit 598 e në vijim të K.Pr.Civile.*
5. Kundër këtij urdhëri *lejohet ankim* në Gjykatë, brenda *5(pesë) ditëve*, nga dita e marrjes dijeni.

**ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT "ASTREA"  
PËRMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT  
ARDIT HAJDINI**

